



SBUNKER POLICY BRIEFS

POLICY BRIEF #2

Konsolidimi ndërkombëtar i shtetësisë: sfidat dhe mundësitë

Autorë: Agon Maliqi dhe Dr. Florian Qehaja

Seria e punimeve



Mbështetur nga:



Prishtinë, Dhjetor 2019

KU QËNDRON PROBLEMI?

Përprjekjet e Kosovës për ta konsoliduar plotësisht shtetësinë në arenën ndërkombëtare janë ngujuar në një rrugë qorre. Marrëveshjet e ndryshme të arritura si pjesë e dialogut të Brukselit (2011-2018) e kanë mundësuar rritjen e kontrollit efektiv mbi territorin dhe integrimin e konsiderueshëm të strukturave paralele të veriut (sado i brishtë të jetë ky integrim). Por në rrafshin ndërkombëtar prej vitesh Kosova nuk ka arritur të çajë përmbajtësisht me rritjen e njohjeve bilaterale apo me anëtarësim në organizata multilaterale, madje është detyruar t'i mbrojtë njohjet ekzistuese. Me fjalë të tjera, shteti është në një pozicion defanziv në kontekst të konsolidimit të shtetësisë në arenën ndërkombëtare. Në anën tjetër, gjatë viteve në vijim, Kosova sipas të gjitha gjasave do të përballet me një kontekst ndërkombëtar edhe më të ndërlikuar, i cili do ta pamundësojë jo vetëm rrugën drejt Kombeve të Bashkuara – e cila ishte gjithmonë shumë e vështirë për shkak të vetos së Rusisë dhe Kinës – por edhe arritjen e njohjeve të mëtutjeshme bilaterale, sidomos atyre që ia hapin rrugën Kosovës drejt synimeve strategjike (anëtarësimin në NATO dhe BE). Sukseset e partive me ideologji populiste nuk i shkojnë për shtati Kosovës – përkundrazi e lëkundin dukshëm pozicionin tonë në raport me këto shtete.

Mungesa e përfshirjes së plotë në sistemin ndërkombëtar prodhon pasoja të rënda dhe shumëdimensionale për zhvillimin e vendit. Perspektiva europiane e Ballkanit Perëndimor është vënë në dyshim serioz ndërsa Kosova ashtu-kështu është në vagonin e fundit në rajon sa i përket proceseve integruese.¹ Por çfarëdo që të jenë raportet e rajonit tonë me BE-në në të ardhmen², Kosova do të përballet me vështirësi qoftë në thellimin e raporteve kontraktuale me BE-në (për shkak të mosnjohjes nga pesë vendet anëtare), qoftë në proceset multilaterale rajonale (për shkak të mosnjohjes dhe pengesave prej Serbisë si dhe Bosnjës e Hercegovinës). Vazhdimi i gjendjes së sotme të cinguar në arenën ndërkombëtare do të thotë se Kosova do të përballet me probleme në krijimin e raporteve normale tregtare, si dhe me perceptimin e pasigurisë juridike për investime, sidomos të atyre strategjike. Kosova tashmë ka humbur shumë kohë me probleme të kësaj natyre dhe – marrë parasysh krizën e emigrimit, papunësinë e lartë dhe problemet sociale – ajo nuk ka shumë kohë për të humbur pa perspektivë të qartë të zhvillimit.

Prezenca e forcave paqeruajtëse të KFOR-it nuk mund të merret si garanci e përjetshme dhe e pakushtëzuar, ndërkohë që Serbia mbetet kërcënim serioz i drejtpërdrejtë për sigurinë e Kosovës. Për shkak të mosnjohjes nga disa shtete anëtare, Kosova nuk ka shteg të hapur për anëtarësim në NATO. Si rrjedhojë, Kosova nuk ka garanci të mbrojtjes së kufijve dhe të sovranitetit në kontekst të vazhdimit të pretendimeve territoriale të Serbisë, veçanërisht ndaj katër komunave të veriut. Kosova me kapacitete të kufizuara vetanake për mbrojtjen e kufijve të vet sot mbështetet në prezencën ushtarake të KFOR-it dhe në mbështetjen (për rrjedhojë disponimin) e partnerëve bilateralë. Duke e marrë parasysh tendencën afatgjate të SHBA-ve për t'u tërhequr gradualisht nga roli i garantuesit të sigurisë së Europës³ si dhe mosgatishmërinë e Europës për ta marrë përsipër këtë rol⁴; duke e pasur parasysh armatosjen në rritje të Serbisë, si dhe interesin e palëve të jashtme si Rusia për ta mbajtur Ballkanin vatër të mundshme jostabiliteti për hapjen e një fronti të ri me perëndimin⁵; etj – Kosova po futet në dhjetëvjeçarin e ardhshëm e brishtë nga perspektiva e sigurisë, me komnat e veriut në rrezik të veçantë. Mundësitë e përdorimit të forcës, qoftë edhe në formë sporadike, janë të mundshme dhe këto përbëjnë kërcënim për sigurinë, sidomos në brezin kufitar.

Paqëndrueshmëria e kësaj situatë ka rritur shqetësimet se Kosovës mund t'i kërkohet të bëjë kompromise të cilat mund ta çënojnë funksionalitetin e shtetit, territorin apo edhe subjektivitetin ndërkombëtar. Nevoja e Kosovës për ta konsoliduar shtetësinë në arenën ndërkombëtare, por edhe shqetësimet e partnerëve strategjikë perëndimorë mbi rreziqet e sigurisë të cilat burojnë nga kontesti mes Kosovës dhe Serbisë për të gjithë rajonin, e kanë prodhuar një besim se normalizimi i plotë i marrëdhënieve duhet të ndodh sa më shpejt. Pritja e aleatëve perëndimorë është se një marrëveshje e tillë do të nënkuptonte "kompromise të dhimbshme" nga palët. Duke qenë se Kosova tashmë e ka bërë një kompromis të vështirë me Pakon e Ahtisaarit, hapësira e Kosovës për lëshime të tjera në rregullimin e brendshëm pa e cenuar funksionalitetin e shtetit është tejet e kufizuar. Për këtë arsye

presionet për kompromise kanë filluar ta largojnë dialogun me Serbinë nga binarët e Pakos së Ahtisaarit që qëndron në themel të shtetësisë. Kosova ndodhet pranë rrezikut që pozitën e vet të cunguar në arenën ndërkombëtare ta zëvendësojë me cungim të brendshëm, humbje të territorit apo edhe me dobësim të subjektivitetit ndërkombëtar.

CILAT JANË SHKAQET E PROBLEMIT?

Demokracitë perëndimore që e mundësuan pavarësinë e Kosovës kanë shënuar rënie relative të fuqisë në raport me fuqitë bllokuese ndaj Kosovës. Shpallja e pavarësisë së Kosovës arriti të njihet nga një numër i madh i shteteve në vitet e para në bazë të një kuptimi liberal të rendit ndërkombëtar, të cilit më vonë i dha legjitimitet vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). Mbi të gjitha, Kosova arriti të njihet për shkak se projekti u shty përpara në vitet e fundit të dominimit unipolar të SHBA-ve në marrëdhëniet ndërkombëtare. Vështirësitë e sotme të Kosovës për ta përmbyllur këtë proces janë rezultat i faktit se konteksti i favorshëm ndërkombëtar i cili e solli Kosovën deri në këtë pikë tashmë nuk ekziston. Pozicionet e Serbisë janë përmirësuar nga fuqizimi dhe agresiviteti i Rusisë si dhe bashkëpunimi në rritje me Kinën. Parimet liberale të së drejtës ndërkombëtare nuk janë më aq përcaktuese sa ç'kanë qenë – jemi kthyer me të dyja këmbët në epokën e realizmit, gjeopolitikës cinike dhe populullimit. Njëkohësisht, SHBA-të nuk janë më aq të fuqishme dhe të interesuara që ta shpenzojnë kapitalin e tyre politik në raportet me Rusinë dhe Kinën në një projekt si Kosova, i cili nga perspektiva e interesave strategjike të SHBA mbetet periferik për nga rëndësia. Sponsorët kryesorë të pavarësisë pra nuk e kanë më kapacitetin për ta çuar punën e nisur me 17 shkurt 2008 deri në fund ashtu siç parashikohej. Mbi të gjitha, shtytësit e ideve liberale dhe humanitare tani më nuk janë në pozita vendimmarrëse, e për rrjedhojë gjenerata e re e diplomatëve dhe politik-bërësve perëndimorë nuk kanë ndjesi kontekstuale të problemeve në Ballkan dhe Kosovë.

Fokusi dhe aftësia e BE-së për t'i zgjidhur problemin e Ballkanit ka shënuar rënie të vazhdueshme si rezultat i krizave të saja brendshme. Europa gjatë viteve të fundit u kaplue nga një seri "tërmetesh" si kriza financiare dhe ajo e Eurozonës, kriza e refugjatëve, lufta në Ukrainë dhe, mbi të gjitha, Brexit-i. Për më tepër, BE-ja u përball me përpjekjet aktive (shpeshherë të suksesshme) të Rusisë për t'i përçarë vendet anëtare. Këto zhvillime e paralizuan vendimmarrjen kolektive dhe e vunë në pah dobësinë e arkitekturës institucionale të BE-së. Ato gjithashtu bënë që BE-ja të mos e ketë vëmendjen e duhur ndaj Ballkanit. Ndërkohë që në opinionin publik të vendeve të BE-së popullariteti i projektit evropian ka filluar të rikthehet⁶, skepticizmi ndaj zgjerimit mbetet shumë i madh.⁷ Skepticizmin e elitave politike të Europës perëndimore ndaj zgjerimit e kanë ushqyer edhe zhgënjimet me rënien e standardeve të qeverisjes në vendet e reja anëtare të lindjes, të cilat sot bien ndesh me vlerat në themel të BE-së, si të drejtat civile, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut, etj. Hungaria dhe Polonia, ku sot sundojnë qeveri autoritare me metoda antidemokratike, apo Rumania dhe Bullgaria, ku korrupsioni mbetet kronik, e kanë vënë në dyshim aftësinë transformuese të BE-së dhe po e shpërfaqin pamundësinë e disiplinimit të shteteve që i shkelin rregullat.

Mospajtimet në mes të Francës dhe Gjermanisë mbi zgjerimin e kanë krijuar nevojën për një konsensus të ri evropian për Ballkanin, por jo edhe vullnetin politik për atë. Presidenti i Francës Emanuel Makron në prill të vitit 2018 për herë të parë u shpreh se nuk duhet të ketë zgjerim të BE-së pa u reformuar njëherë vetë BE-ja dhe pa ndryshuar procesi i vlerësimit të vendeve candidate. Së voni, me veton e Francës ndaj hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, Makron e mbajti fjalën dhe efektivisht e mbylli perspektivën e anëtarësimit për gjithë rajonin. Tani në nivel të BE-së po diskutohet mundësia e një konsensusi të ri për Ballkanin dhe po gjejnë mbështetje ide alternative. Propozimi i Francës është që vendeve të Ballkanit t'u premtohet perspektiva e anëtarësimit, por të ndryshohet (më saktë, të vështirësohet) metodologjia e vlerësimit.⁸ Kritikët e shohin këtë propozim e shohin si përpjekje për ta mbajtur Ballkanin jashtë. Propozimi tjetër është ai i European Stability Initiative (ESI) në Berlin që Ballkanit t'i ofrohet mundësia e anëtarësimit vetëm në Zonën Ekonomike Europiane (EEA), sipas modelit të Norvegjisë.⁹ Një proces i ri dhe një perspektivë e qartë dhe realiste për të ardhmen mund ta rikthejë deri diku kredibilitetin e BE-së në raport me rajonin, por ai gjithsesi do ta dobësojë fuqinë e saj përcaktuese në zhvillimet gjeopolitike.

Mungesa e perspektivës për anëtarësim do të thotë se BE-ja nuk mund të shërbejë më si busull orientuese apo edhe si mekanizëm për ta detyruar Serbinë që ta njohë Kosovën. Procesi i integrimi europian shërbeu në Ballkan si instrument kyç i demokratizimit dhe paqëtimit. Aspirata e Kosovës dhe Serbisë për t'u anëtarësuar në BE i bënte të dyja të kushtëzueshme nga perëndimi, ndërsa vetë anëtarësimi supozohej se do t'i bënte kufijtë të parëndësishëm. Pritja ishte se njohja e Kosovës eventualisht do të ishte kusht për anëtarësimin e Serbisë në BE, prandaj edhe dialogu i ri – i cili nisi në vitin 2011 si teknik dhe më pas u bë politik – kaloi nën ombrellën e BE-së. Por pikërisht kur procesi duhej të hynte në etapën e tij të fundit drejt marrëveshjes së normalizimit, kriza e BE-së ia hoqi perëndimit levën kryesore. Pa perspektivën e anëtarësimin në BE, Serbia nuk e ka asnjë shtysë të fortë për ta njohur Kosovën. Si rrjedhojë, është zvogëluar në masë të konsiderueshme pesha dhe rëndësia BE-së si palë ndërmjetësuese në zgjidhjen e kontestit mes Kosovës dhe Serbisë, por edhe pesha e Gjermanisë – partnerit kryesor strategjik të Kosovës brenda BE-së. Gjithashtu, me zbehjen e busullës orientuese të integrimi europian, rajoni nuk ka më shtytës të jashtëm drejt demokratizimit dhe paqes, gjë që i vë në plan të parë shqetësimet e sigurisë.

Rikthimi i rolit prijës të SHBA-ve në rajon mund të jetë e vetmja shpresë për zhbllokimin e situatës dhe parandalimin e përkeqësimit të rrethanave të sigurisë. SHBA-të në kohën e administratës së Obamas ia lanë rolin prijës në Ballkan BE-së, si pjesë e strategjisë së tyre për tërheqjen graduale nga të qenit fuqi europiane dhe kthimin e fokusit në Azi. Kosova kështu prej vitesh nuk ndërlihej me asnjë prej interesaveve strategjike të SHBA, me përjashtim të luftës kundër terrorizmit. Për këtë arsye SHBA-të nuk kanë pasur mundësi dhe as interes që të shpenzojnë kapital të mjaftueshëm politik për t'i shtyrë përpara njohjet e Kosovës apo anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare. Kosova është rikthyer në radarin e interesave amerikane gjatë administratës Trump për arsye të ndryshme. Një prej tyre është shqetësimi strategjik për sigurinë e rajonit në kontekst të humbjes së perspektivës europiane, si dhe hapësirës që u krijohet fuqive konkurruese si Rusia dhe Kina. Këto dinamika përbëjnë shqetësim strategjik për SHBA-të në kontekst të rikthimit të "garës mes fuqive të mëdha".¹⁰ Interesimi i ri i SHBA për Ballkanin, i materializuar me emërimin e dy të dërguarve specialë (njëri nga Departamenti i Shtetit për Ballkanin në përgjithësi, dhe tjetri nga Presidenti Trump për dialogun Kosovë-Serbi), ndërlihet me dëshirën strategjike për ta izoluar Ballkanin nga ndonjë destabilizim i mundshëm nga forcat destruktive, duke filluar me mbylljen e çështjes delikate në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kosova nuk i ka ndihmuar vetes me qasjen kryeneçe dhe ka harruar se asimetria e fuqisë ndaj Serbisë nuk thyhet pa bashkëpunimin me aleatët. Partnerët tanë strategjik kanë investuar jashtëzakonisht shumë për paqen dhe sigurinë në Kosovë, prandaj edhe janë hisedarë dhe kreditorë të shtetësisë. Kosova vazhdon të ketë nevojë për mbështetjen e aleatëve për ta thyer asimetrinë e fuqisë në etapën e fundit të procesit. Kosova gjatë viteve të fundit është përpjekur të tregojë autonomi veprimi në raport me aleatët, gjë kjo e mirëseardhur, por shpeshherë këtë e ka bërë në mënyrën e gabuar – jo vetëm duke mos u koordinuar, por edhe duke u konfrontuar me aleatët. Kosova ka ndërmarrë hapa unilateral në afekt, apo edhe është ngujuar në pozicione pa u menduar mirë për pasojat apo për rrugëdaljet dhe qëllimet përfundimtare, sepse shpeshherë këta hapa janë marrë për motive të brendshme politike. Kjo qasje gjithnjë e më izoluese dhe aventuriere, që u pa në çështjet si demarkacioni me Malin e Zi apo edhe te taksat ndaj Serbisë, e ka dëmtuar kredibilitetin e Kosovës në sytë e partnerëve, e ka thelluar izolimin tonë ndërkombëtar dhe, ç'është më e rëndësishmja, i ka çuar raportet me SHBA-të në pikën e tyre më të ulët në 20 vjet.¹¹ Kosova nuk e ka luksin ta humbasë mbështetjen e qendrave të vendimarrjes në një kohë kur Serbia është fuqizuar dhe me ndihmen Ruisë e ka nisur fushatën e çnjohjeve. Prandaj Kosova duhet të ndryshojë qasje – jo duke hequr dorë nga liria e veprimit, por duke i shtyrë përpara interesat me bashkërendim.

CILAT JANE ZGJIDHJET?

Opsioni 1: Përmbyllja e konsolidimit ndërkombëtar të shtetësisë përmes dialogut me Serbinë

Kosova dhe Serbia gjatë vitit tjetër me gjasë do të përballen me nje valë të re të presionit ndërkombëtar për ta nisur një proces të ri të dialogut për marrëveshjen e normalizimit. Koha më e mundshme për rifillimin e dialogut mund të jetë pranvera – pas konsolidimit të institucioneve në Kosovë, pas zgjedhjeve në Serbi dhe pas debateve që pritet ta qartësojnë të ardhmen europiane të rajonit në Samitin e Këshillit Europian në Zagreb në Maj 2020. Gjatë muajve në vijim, në mesin e shteteve të Quint-it, veçanërisht në mes të Uashingtonit dhe Berlinit, do të ketë përpjekje për t'i përcaktuar kornizat dhe parimet e procesit të dialogut. Shenjat janë se administrata Trump është e interesuar që vitin tjetër të arrihet marrëveshje, një pikë ku Gjermania thuhet të jetë hezituese. Ekziston mundësia se një marrëveshje edhe mund të servohet si e gatshme nga SHBA nëse ritmi i procesit nuk është i kënaqshëm. Spektri politik në Kosovë rrezikon të kapet i papërgatitur nga zhvillimet. Kosova duhet të jetë më proaktive në definimin e interesave dhe parimeve për skenarin e dialogut të shpejtë.

Kosova duhet ta evitojë skenarin ku ajo mund të fajësohet për dështimin e dialogut dhe nuk mund të bëjë baste që e rrezikojnë mbështetjen amerikane. Në valën e kryeneçësisë diplomatike të viteve të fundit është forcuar bindja se Kosova në mbrojtjen e interesave të veta mund t'i shpërfillë krejtësisht kërkesat dhe interesat aleatëve. Një prej interesave më madhore të Kosovës, për shkak të asimetrisë së fuqisë ndaj Serbisë, është pikërisht ruajtja e mbështetjes së partnerëve që janë garantues të sigurisë dhe mbështetës në arenën ndërkombëtare. Kosova në asnjë rrethanë nuk guxon të jetë pala që gjykohet si penguese e procesit të dialogut me masa të njëanshme, sado të drejta të duken ato për ne. Llogaritjet se Kosova mund ta zhgatisë procesin dhe ta presë ndryshimin e administratës amerikane janë baste të rrezikshme të cilat, ashtu siç kanë paralajmëruar zyrtarë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë, mund të shkaktojnë dëme strukturore në marrëdhëniet me SHBA-të.¹² Duke e pasur parasysh natyrën e paparshikueshme të Presidentit Trump, pasojat mund të jenë edhe të menjëhershme. Për më tepër, nuk ka kurrëfarë garancie se administrata në SHBA do të ndryshojë dhe kurrëfarë garancie se një administratë e Partisë Demokratike do të ketë qasje tjetër në raport me Ballkanin. Tendencat afatgjate e politikës së jashtme amerikane është tërheqja nga roli prijës në shumë rajone, veçanërisht në Europë. Kosova nuk duhet t'i japë pretekst SHBA-ve për ta braktisur rajonin si aktor i sigurisë sepse Kosova historikisht nuk ka mundur dhe nuk duhet të llogarisë në Europën për të treguar vendosshmëri në zgjidhjen e drejtë të problemeve.

Kosova në procesin e dialogut duhet t'i definojë qartë interesat e veta, të cilat duhet të jenë pikënisje për çdo gjë, përfshi edhe manovrimin e përçarjes mes aleatëve. Debati publik në Kosovë gjatë viteve të fundit mbi dialogun është ndotur nga debatet dhe inatet e brendshme politike të cilat e kanë pamundësuar arritjen e konsensusit minimal. Idetë nuk janë vlerësuar për nga cilësia e tyre por varësisht nga ajo se kush dhe për çfarë motivesh politike i ka shtyrë. Mungesa e këtij konsensusi të brendshëm dhe e aftësisë për t'i definuar interesat e Kosovës ka bërë që gjatë vitit të fundit çarja mes aleatëve perëndimorë rreth çështjes së dialogut të reflektohet edhe në debatin tonë të brendshëm. Kosova ka nevojë që t'i definojë qartë interesat dhe synimet e saja strategjike pa ndërhyrje të jashtme dhe vetë të përcaktojë se çfarë lloj kompromisi do të mund të ishte i pranueshëm. Ne vlerësojmë se çfarëdo marrëveshje që përputhet me tre synimet e mëposhtme strategjike të Kosovës mund të jetë e pranueshme.

a) Marrëveshja duhet ta konsolidojë subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës

Kosova nuk duhet të lejojë që si pjesë e çfarëdo marrëveshjeje të vihet në pikëpyetje subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës. Subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës nuk e përjashton mundësinë që Kosova si entitet në të ardhmën të bëhet pjesë e entiteteve konfederale, rajonale, europiane apo botërore. Vendimet e tilla duhet të jenë vendime të shtetit sovran dhe të njohur ndërkombëtarisht të Kosovës.

b) Marrëveshja duhet t'ia çelë menjëherë Kosovës rrugën për të hyrë në NATO dhe për të ndërtuar marrëdhënie të papenguara kontraktuale me BE-në.

Pjesë themelore e çfarëdo marrëveshjeje duhet të jetë miratimi i një rezolute në OKB e cila ia çelë Kosovës rrugën t'u bërë anëtare e plotë. Në rast se Rusia apo Kina këtu shfaqen si pengesë, Kosova duhet ta vendosë si kusht ndaj garantuesve ndërkombëtarë të marrëveshjes sigurimin e njohjes së menjëhershme të Kosovës prej të gjitha shteteve anëtare të NATO-s dhe BE-së. Kjo gjë do t'i mundësonte Kosovës që të paktën të futej menjëherë në proces për anëtarësim në NATO – element kyç i sigurisë – dhe të mos ketë pengesa për të ndërtuar raporte kontraktuale me BE-në.

c) Marrëveshja duhet ta garantojë funksionalitetin e brendshëm të Kosovës

Pakaja e Ahtisaarit tashmë e ka çuar Kosovën në skajshmëri të funksionalitetit sa i përket rregullimit të brendshëm. Gjithsesi, çfarëdo hapësire manovruese që ekziston për t'i akomoduar shqetësimet e pakicave duhet të përdoret. Por Kosova në asnjë rrethanë nuk duhet të lejojë zëvendësimin e pozitës së cunguar ndërkombëtare me cungim të brendshëm dhe vazhdim të varësisë nga Serbia.

Opsioni 2: Dështimi i dialogut dhe qasja bilaterale në politikën e jashtme

Në rast të dështimit të dialogut dhe në mungesë të perspektivës europiane Kosova duhet t'u japë prioritet marrëdhënieve bilaterale me partnerët kryesorë strategjikë. Kosova duhet ta përshtasë strategjinë e vet të përgjithshme të politikës së jashtme, duke u dhënë prioritet shqetësimeve të sigurisë dhe marrëdhënieve bilaterale me shtetet aleate. Kosova tashmë e ka rritur kontrollin efektiv mbi territorin dhe e ka një numër të konsiderueshëm njohjesh, por duhet të gjejë mbështetje për t'i mbrojtur arritjet e deritashme. Për këtë arsye prioritet duhet t'u jepet marrëdhënieve me partnerët kryesorë të sigurisë – veçanërisht SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Turqisë. Gjithashtu, prioritet duhet t'u jepet marrëdhënieve me Gjermaninë për mbështetje politike brenda BE-së dhe Këshillit të Europës, si dhe për t'u siguruar që Kosova të mos përjashtohet nga çfarëdo arkitekture e re europiane në Ballkan, veçanërisht për qasjen në tregun europian. Në kontekst rajonal, Kosova duhet të synojë heqjen e barrierave me vendet e rajonit si dhe thellimin dhe strukturimin e marrëdhënies speciale me Shqipërinë në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Në kontekst të marrëdhënieve bilaterale përtej botës euro-atlantike dhe rritjes së fuqisë së Kinës, Kosova duhet të synojë krijimin e partneriteteve strategjike me shtete rivale dhe miqësore si Japonia. Kosova duhet të hap edhe shtigje të reja në marrëdhëniet bilaterale me shtetet të tjera në rritje si Pakistani apo Tajlanda.

Krahas fuqizimit të bashkëpunimit bilateral me këto shtete, Kosova duhet të vazhdojë parreshtur me përpjekjet për anëtarësimin në organizata multilaterale. Prioritet në këtë kontekst duhet të kenë Këshilli i Europës, INTERPOL dhe UNESCO. Rezistenca e Serbisë në vitet e ardhshme do të bjerë edhe për shkak të premtimeve që ajo u ka dhënë shteteve të ndryshme në këmbim të bllokimeve të deritashme, të cilat ajo vështirë se do të mund t'i zbatojë. Tutje, në rrethanat e tilla, Kosova do të duhej të konsiderojë aplikimin për marrjen e statusit të shtetit-vëzhgues në OKB si një formë e hyrjes në OKB nëpërmjet 'derës dytësore'. Për arritjen e saj nevojitet vetëm votimi në Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të OKB-së (+97 shtete). Nominalisht ky numër do të mund të arrihej, sidomos krahasuar me votimin në organizatat e mësipërme, ku kushti për 2/3 të votave ka qenë vështirë i arritshëm kur Serbia, e ndihmuar nga Rusia, e siguronte në vazhdimësi kundërshtimin e 1/3 të shteteve. Për këtë nismë do të ishte më e dobishme që të siguroheshin sponsorë më neutralë dhe jo polarizues.

REFERENCAT

¹ Serbia dhe Mali i Zi janë vende me status kandidati dhe i kanë hapur negociatat. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë në pritje të hapjes së negociatave. Bosnja dhe Hercegovina e ka dorëzuar aplikimin për status të kandidatit në vitin 2016. Kosova ka vetëm Marrëveshje të Stabilizimit Asocimit (MSA).

² Mungesa e vendimit të Këshillit të Europës për t'i hapur negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si dhe propozimet që po qarkullojnë për ndryshimin e metodologjisë së anëtarësimit, apo propozimet që Ballkanit t'i hapet rrugë vetëm për në tregun e përbashkët, i kanë rritur dyshimet në perspektivën europiane të rajonit. Për një analizë koncize të shkaqeve, lexojeni analisten Judey Dempsey nga Carnegie Endowment: "Europe's Enlargement Problem: <https://carnegieeurope.eu/strategieurope/80203>

³ Argument i shtjelluar gjerësisht nga Robert Kagan në librin "Xhungla rritet sërisht: Amerika dhe bota jonë në rrezik" (2018)

⁴ Judy Dempsey: "Makron sfidon Evropën që jeton në mohim"
<https://carnegieeurope.eu/strategieurope/80319>

⁵ "Loja e Rusisë në Ballkan" – Paul Stronsky dhe Annie Himes, Carnegie Endowment for International Peace. Shkurt 2019

⁶ Sipas Eurobarometrit të pranverës së vitit 2019, 61 përqind të qytetarëve të 27 vendeve të BE-së mendojnë se BE-ja është diçka pozitive.
<https://www.europarl.europa.eu/at-your-service/files/be-heard/eurobarometer/2019/closer-to-the-citizens-closer-to-the-ballot/executive-summary/en-parlemeter-2019-executive-summary.pdf>

⁷ Zgjerimi drejt vendeve të Ballkanit gëzon mbështetje të ulët në shumicën e vendeve të mëdha të BE-së, sipas anketës së Këshillit Europian për Politikë të Jashtme (ECFR): https://www.ecfr.eu/article/commentary_europes_new_agenda_in_the_western_balkans

⁸ "France unveils new model of EU enlargement" – EU Observer <https://euobserver.com/enlargement/146624>

⁹ European Stability Initiative. "Coup de grâce – Delors and squaring the circle – Norway in the Balkans". (October 2019)
https://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=67&newsletter_ID=137

¹⁰ "National Security Strategy of the United States of America" Dhjetor, 2017
<https://www.whitehouse.gov/wp-content/uploads/2017/12/NSS-Final-12-18-2017-0905-2.pdf>

¹¹ Analisti Jim Hooper: "Marrëdhëniet Kosovë-SHBA në nivelin më të ulët në 20 vjet". <https://www.zeramerikes.com/a/hooper-kosovo-us/4870027.html>

¹² "Tarifa kërcënon aleancën më të rëndësishme të Kosovës" – Reporter <https://www.reporter.al/tarifa-kercenon-aleancen-me-te-rendesishme-te-kosoves/>